



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 119, datë 31.08.2020

PËR

REFUZIMIN E KËRKESËS PËR NJOHJEN E SHOQËRISË “AZIMUTH” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit “Për Titujt”, i ndryshuar, si dhe nenit 15, të Rregullores nr. 71, datë 27.03.2019 “Për veprimtarinë e agjentit të shoqërisë së brokerimit në tituj”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Shoqëria “AZIMUTH” sh.a., me shkresat e datës 11.12.2019 dhe 05.02.2020, protokolluar në Autoritet me nr. 3793 prot., datë 11.12.2019 dhe nr. 3793/1 prot., datë 06.02.2020, ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për njohjen e veprimtarisë së agjentit të shoqërisë së brokerimit në tituj, “Magnum FX (Cyprus) Ltd”, të licencuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë të Qipros.

Pas shqyrtimit të informacionit dhe dokumentacionit të depozituar, rezulton se:

1. Dokumentacioni i depozituar nga shoqëria “AZIMUTH” sh.a., nuk është i plotë referuar kërkesave të nenit 9 dhe 10, të Rregullores nr. 71 datë 27.03.2019 “Për Veprimtarinë e Agjentit të Shoqërisë së Brokerimit në Tituj”;
2. Sipas informacionit të marrë nga faqja zyrtare e Komisionit të Letrave me Vlerë të Qipros (CySEC), firma e investimit (shoqëria e brokerimit) “Magnum FX (Cyprus) Ltd”, ka qënë subjekt i dy vendimeve të Komisionit, më konkretisht:
 - a. Me vendimin e datës 01.06.2020, i është pezulluar pjesërisht autorizimi;

b. Me vendimin e datës 15.06.2020, është vendosur revokimi i vendimit të mëparshëm duke marrë parasysh masat e marra nga shoqëria si:

- Mos pranimi i klientëve të rinj;
- Ndërprerja e çdo shërbimi marketimi dhe promovimi i shërbimeve të tij.

Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë mos plotësimin e kërkesave të Rregullores nr. 71, datë 27.03.2019 “Për veprimtarinë e agjentit të shoqërisë së brokerimit në tituj”, nga shoqëria “AZIMUTH” sh.a., si dhe vendimet e Komisionit të Letrave me Vlerë të Qipros për shoqërinë “Magnum FX (Cyprus) Ltd”,

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Refuzimin e kërkesës për njohjen e shoqërisë “AZIMUTH” sh.a., për të vepruar si agjent i shoqërisë së brokerimit në tituj “Magnum FX (Cyprus) Ltd”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE